

20210711064

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 25 paragrafi 1 dhe 3 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 500 DENARË ME KARAKTERISTIKA TË NDRYSHUARA

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim kartëmonedhat me vlerë nominale 500 denarë me shenjë të shtypjes "Април 2020" (Prill 2020) dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetimin e vlerave nominale dhe karakteristikave themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96), Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 500 dhe 1000 denarë, me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/03) dhe Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 500, me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/19 dhe nr. 88/20), duke filluar nga data 1 prill i vitit 2021.

2. Me lëshimin në qarkullim të kartëmonedhave nga pika 1 e këtij vendimi, paralelisht në qarkullim në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të jenë edhe kartëmonedhat me vlerë nominale 500 denarë, të emetuara në bazë të Vendimin për emetimin e vlerave nominale dhe karakteristikave themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96) dhe Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 500 dhe 1000 denarë, me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/03).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr.V. 02-15/IV-3/2021
26 mars viti 2021
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
D-r. Anita Angelovska-Bezhoska